



ENTI BOTUES



Poradeci

tel: +355 83 222 905

Në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë Nr. 490 Edicioni - Verë 2012 Çmimi 20 Lekë



Kam punuar pa interes vetiak, bile kundër interesit vetiak. Nuk kam ndjekur kurrë pasurimin tim, sepse ky pasurim mnund të bëhej vetëm me dy mjete: me vjedhje (ka një mijë e një mënyra vjedhjeje dhe unë s'kam përdorur asnjërën) dhe me tradhëti, duke u shërbyer të huajve për të grabitur vendin dhe duke marrë para për këtë shërbim. Zgjedha rrugën e kundërt: luftën kundër atyre që donin të grabisnin, atyre që grabisnin. Nuk i ndala dot të tëra, jo se s'desha, je se kisha interes, po se s'munda. Kaq munda, kaq bëra. Kundër grabitjeve italiane, kundër grabitjeve gjermane, kundër grabitjeve jugosllave. Nuk zgjedha kurrë udhën e rehatit vetjak, udhën "urtë e butë e lugën plot".

Fëmijët i porositi ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile atëherë kur të vret. Këtu kanë lindur, këtu të rrojnë me mish e shpirt, qoftë edhe me dhembje.

Fragment nga "Testamenti"



100 Vjet Shtet Shqiptar

Ky edicion i gazetës

Nositi botohet në kuadër

të 100 vjetorit të

Pavarësisë

Suplement nga

Grupi Monitorues i

Këshillit Bashkiak

Angazhohu
Monitoro
Vepro



Lexoni në faqen 5-12

Bota Lasgushiane, Atdheu,
Dashuria, Natyra

Shkruar nga: Budjon XHELO

Lexoni në faqen 15

Botohet për herë të
parë letra e Fan Nolit
drejtuar Mitrush Kutelit

Faqe 14

Në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë
Në 45 vjetorin e vdekjes së Mitrush Kutelit flasin:

Aurel Plasari	faqe 2,4
Atalanta Pasko	faqe 3
Eva Çollaku	faqe 3
Adrian Civici	faqe 13
Mirush Kabashi	faqe 14



Kuteli dhe eposi kutelian

Dr. Aurel Plasari

Jam mirënjohës që jam ftuar në këtë veprimtari e cila i takon të jetë edhe për mua personalisht 20-vjetori i mundësisë për t'u marrë me studimin e veprës së Mitrush Kutelit. Mbaj mend që në 8 dhjetorin e 90-ës, kur në Tiranë mbledheshin studentët udhëtonim për në Pogradec për veprimtarinë kushtuar Mitrush Kutelit. Një udhëtim i jashtëzakonshëm, sepse ne mikrobusin e asaj kohe bënte pjesë edhe prof. Vedat Kokona, bashkëfajtor i Kutelit në revistën letrare. Dhe është kënaqësi e madhe të konstatosh, që tani e 20 vjet Pogradeci i qëndron besnik kultit të dy shkrimtarëve të mëdhenj të tij Mitrush Kutelit dhe Lasgush Poradecit.

Do përpiqem të parashtroj në tri rrafshë kontributin, meritat dhe Kutelin si edukator, si formues i njeriut shqiptar, si mjeshtër model për formimin letrar të shqiptarit të sotëm dhe si model modaliteti qytetar dhe atdhetar. Kuteli është nga këta shkrimtarë që mund ta formojë njeriun shqiptar prej fëminie deri në pragun e mbarimit të jetës ose të përgatitjes për t'u ndarë nga jeta. Kur them qysh femijë kam parasysh përrallat e tij, ato lexime në thonjëza që femijës mund t'ia bëjnë të tjerët ngaqë s'ka filluar të lexojë: Përrallat e Xinxifillos dhe përralla të tjera përfshirë këtu edhe një numër të mirë përrallash të përkthyer prej tij nga letërsia botërore. Janë për formimin e femijës, hapja e derës së botës së madhe, për jetën që e pret; jeta që e pret cilindo femijë.

Mandej, Kuteli mund të pjellë Kutelin tonë gjatë adoleshencës. Kryesore ose kryevepër për këtë moshë unë do të quaja "Tregime të moçme shqiptare". Njohja me adoleshentët dhe me të rinjtë shqiptarë me "Eposin shqiptar të kreshnikëve", madje me saktë me dy gjysmat e këtij eposi: Atë të mbledhur në "Malet e Shqipërisë" dhe në vargun Të ikurit e mëdhenj... Në të dy gjysmat e këtij rruzulli të këtij adoleshenti shqiptar do njohë përveç trimave të mëdhenj shqiptarë në veçanti Skënderbeun, i cili është i pranishëm në të dy



Të nderuar pjesëmarrës,

Zonja dhe zoterinj, pjesëtarë të familjes së Mitrush Kutelit, miq, bashkëqytetarë, mësues e nxënës, drejtues të arsimit në rreth.

Të gjithë ne jemi të gëzuar që sot në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë dhe në përkujtim të 45-vjetorit të vdekjes së Mitrush Kutelit, ndodhemi në vendlindjen e dy magjistarëve të gjuhës shqipe, Lasgush Poradeci e Mitrush Kuteli.

Jemi mbledhur të nderojmë Kutelin e madh, poet, shkrimtar, përkthyes i talentuar, studiues i thellë i kulturës, historisë dhe letërsisë shqiptare, ekonomist i shkëlqyer (nga ai klas që të paralajmëron dhe të mëson si të dalësh nga kriza), erudit dhe atdhetar i madh.

Me lejoni të falenderoj Z. Jemin Gjana, deputet i Kuvendit të Shqipërisë; Z. Adrian Tane, zëvendës ministër i Arsimit dhe Shkencës; Z. Niko Dudo, nënprefekt i qarkut Korçë; Z. Aurel Plasari, studiues; Z. Adrian Civici, ekonomist, profesor në UET; Z. Mirush Kabashi, aktor i mirënjohur; Znj. Atalanta Pasko, e bija e shkrimtarit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes dhe në veçanti Drejtorin e Zyrës Arsimore Pogradec, znj. Eva Çollaku, frymëzuesja dhe organizatorja e këtij eventit kulturor.

Budjon Xhelo, moderator i aktivitetit

pjesët e këtij eposi. Por "Tregime të moçme shqiptare" nuk e formon njeriun shqiptar vetëm për moshën e adoleshencës dhe të rinisë.

Është një ngarkesë shpirtërore, psikologjike dhe mendore që të mbetet për gjithë jetën duke pasur parasysh që e shumta e qytetarëve shqiptarë nuk kanë, nuk do të kenë, nuk kanë pse ta kenë mundësinë të lexojnë eposin origjinal, përveç profesionistëve që interesohen për atë degë të shkencës dhe sidomos të eposit të arbëreshëve, i cili është edhe nga ana gjuhësore shumë i vështirë për t'u përkapur, për t'u perceptuar. Pra, besoj që qindra, mijëra shqiptarë eposin e mbajnë të regjistruar në vetëdijen e tyre pikërisht nëpërmjet "Tregime të moçme shqiptare", ose kanë mundësi ta mbajnë të tillë në rast se duan, dëshirojnë. Vijnë mandej veprat, që ju me siguri i njihni "Netë shqiptare", "Ago Jakupi", etj. rrëfime, "Kapllon Aga i Shaban Shtatës".

Mbushja e njeriut shqiptar me

histori të mrekullueshme të historive shqiptare, të jetës së njerëzve nga më të thjeshtët deri te ata më të lartët, të historisë së vjetër shqiptare, të bashkëkohësisë shqiptare dhe sidomos të kohës mistike shqiptare, ambicje që Kuteli e mbajti deri në fundin e jetës së tij, ambicje për ta hulumtuar pikërisht këtë botë mistike dhe njëkohësisht ambicje që e dallon edhe prej shumë shkrimtarëve bashkëkohës të tij, por edhe prej shkrimtarëve pasardhës të tij. Ne, rritemi, burrërohemi dhe përsëri Kuteli na ndihmon në formimin tonë edhe nëpërmjet kryeveprave nga letërsia botërore që ka përkthyer. Unë do të këndoja vetëm pjesën më interesante të përkthimeve të tij, atë pjesë që vjen nga letërsia e madhe ruse: Gogolin, Pushkinin, Kurtinillin, Pausovskin, nuk përjashtoj edhe disa vepra të Gorkit. Është një mundësi e rrallë formimi me përkthime të transmetuara nëpërmjet gjuhës së Kutelit. Por sa më shumë rritemi dhe i afrohem

fundit të jetës jemi në pjesën e dytë të jetës sonë fillojmë të kuptojmë edhe sekretet e saj të mëdha nëpërmjet veprave të Kutelit sidomos me kryeveprën "E madhe është gjëma e mëkatit", e cila në njëfarë mënyre përbën për njeriun një lloj manuali i aktit të të vdekurit, sepse vetë vdekja është një akt më vete, ndoshta është akti i parathënë në një formë skice ose tregimi, që ju e njihni qysh e gjeti Ago Jakupi udhën e Zotit.

Si fillon ndryshon njeriu kur e kupton, që po i vjen fundi do t'i bëhet bilanci dhe duhet të lerë llogaritë në këtë botë, por edhe për njeriun që mendon që llogaritë do t'i bëhen edhe në botën tjetër. Kuteli, model tjetër si mjeshtër për formimin letrar të atyre që duan të dashurohen, që kanë ambicje të dëshpërohen e të lejojnë. Pikësëpari tek Kuteli fokusojmë artin e prozës së madhe, jo të prozës në sasi e vëllim, por të prozës së madhe si cilësi. Rrëfjenjen, që ne jemi të detyruar si nën xhama ta njohim si një përfitim të tijen origjinal, prej cilit mund të mësohet, po i cili nuk mund të imitohet. Po prej Kutelit njeriu me ambicje për të shkruar mund të mësojë artin e kritikës letrare, të asaj pjese të veprës së Kutelit që ai me shumë modesti e titullonte ose e nëntitullonte shënime letrare. Nga kritika e tij letrare, njeriu që dëshiron të merret me kritikë mund të dallojë në radhë të parë ndershmërinë, ndershmërinë letrare të themi dhe qytetare. Duke pasur parasysh kohën e vështirë kur bënte kritikë letrare Mitrush Kuteli, kohë e cila edhe sot nuk mund të thuhet që është përmirësuar, sepse edhe në realitetin në të cilin ne jetojmë, kritika letrare si të gjitha kritikën vazhdon të jetë e vështirë me specifikat që ia kushtëzon një shoqëri e vogël dhe këtë ne duhet ta pranojmë. Ne nuk jemi një shoqëri e madhe si shoqëria anglosaksone, ose amerikane, ose franceze. Jemi ajo shoqëri për të cilën Kuteli thoshte figurativisht që: "Autori të vë koburen në gjoks, jo se e ke sharë, por se nuk e ke luvduar sa do të donte ai që ti ta luvdoje".

(vijon në faqen 4...)

Në emër të familjes flet Atalanta Pasko, vajza e Mitrush Kutelit

JO ÇFARË I KANË BËRË, POR ÇFARË KA BËRË KY NJERI



Jam një nga vajzat dhe për fat këtu jam më shumë në vend edhe të vëllait dhe më vjen shumë keq dhe në fakt atij i erdhi edhe më shumë keq që nuk mundi të vijë. Do të ishte megjithëmend një kënaqësi shumë e madhe për atë në radhë të parë, por ishte e pamundur.

Unë dua thjesht një reflektim të familjes për mënyrën sesi vijnë personazhet e kohëve të kaluara, të atyre kohëve, që edhe kujtesa pak nga pak zbehet, pak nga pak bëhet më pak e saktë, më pak e qartë, më me pak detaje, gjithsesi vjen dhe serviret. (Është gjë shumë e mirë që vjen dhe shumë e mirë që lidhet, lidhen mirë fijet e mendjes, mendimit me ato fije të

vogla, të holla shumë të gjakut, që e bëjnë pikërisht në atë të veçantën)... Shumë herë duke sjellë një personazh të tillë nuk e vemë theksin kryesor çfarë ka bërë ky njeri, po çfarë i kanë bërë. Kjo është një vuajtje shumë e madhe për familjet.

Flas edhe për familjen tonë. Është një mënyrë spekulative e ditëve të sotme, që në vend që ta çojmë të tërë energjinë tonë të mendimi, e çojmë thjesht tek një emocion i përkohshëm, shumë i zbehtë, i pavlefshëm, ku të qajmë se çfarë i bëmë këtij apo atij personazhi. Është e pavlefshme, do të themi çfarë bëri, njësoj siç u tha në këtë takim, që për mua është nga takimet më të bukura që janë bërë për Kutelin, për babain. Sepse duke u thënë çfarë bëri, ai është i vlefshëm, ai është edhe emocional në mënyrën e tij, duke folur ai vetë dhe jo duke folur të tjerët për gjëra që shumë prej tyre nuk i kanë parë. E

kam fjalën për episode të ndryshme, që tregohen e ritregohen, tregohen duke ju shtuar siç thonë këtu në Pogradec, me këmbë e doçka, dhe që megjithëmend i shton në atë që di të vërtetën. Por është edhe një anë tjetër, në shumë mënyra se si vjen personazhi i ditëve të kaluara. Mundohet që njerëzit që i risjellin ta trajtojnë sa më të vuajtur, mundësisht të zhveshur edhe nga pesha e tij, mundësisht të depersonalizuar dhe duan t'ia shtojnë vlerat duke e depersonalizuar. Jo kjo nuk ka ndodhur njerëzit e formuar dhe të prerjes të Kutelit e kanë ruajtur personalitetin e tyre e kanë ruajtur peshën e tyre në të gjitha rrethanat ku janë, ku i ka ecur fati, duke filluar që nga ..., duke vazhduar me vrullin e heshtjes që vihej përballë tyre nga struktura...).

Dhe kjo ka qënë deri në fund, deri në vdekje, dmth. dinjitetin e tyre kanë ditur ta mbrojnë, kanë ditur të përballen sipas mënyrës së tyre. Mjafton të themi këtë gjë dhe i kemi bërë shërbimin më të madh kujtesës tonë. Kaq! Faleminderit!

Nga fjala e Znj. Eva Çollaku, Drejtore e Zyrës Arsimore Pogradec

Le ta kujtojmë Kutelin e madh...

Jemi sot këtu në nderim dhe respekt të veprës dhe jetës së Mitrush Kutelit, njëri prej identiteteve të fushës së letërsisë, ekonomisë dhe atdhetarisë shqiptare e asaj poradecare në veçanti.

Në rrugëtimin e ndërmarrë nga ZA Pogradec nëpër labirinthe të mendimit dhe përmasave të tij, të përfaqësuar nga figurat e shquara të këtij qyteti, pozicioni i Mitrush Kutelit qëndron i fokusuar në konversitetin optikal të epokës, me shumëplanet e formës dhe përmbajtjes duke na servitur portretin më të plotë e përfaqësues të intelektualit elegant dhe tepër sqimatar në përzgjedhjet e përshtatjet e asaj çka vjen nga thellësia e shekujve me erën e re që për vitet kur jetoi Kuteli në Shqipëri ishte ende embrion.

Në horizontin që ne duam të kapim dhe të hapim spektrin e të cilit e përbëjnë modelet që i kanë rezistuar kohës dhe mbeten impulse për potencimin e vizionit që një shoqëri njerëzore në dixhitalizim duhet të ketë obligim, pozicioni i Mitrush Kutelit është ai i kufirit midis dy nivele të tradicionit dhe modernizimit, ku modernizimi e përforcon ndërgjegjien e vetë letërsisë si domosdoshmëri në zhvillimin e saj në të ardhmen. Kuteli ishte ndër të parët që doli me dy konkluzione tepër të rëndësishme. Së pari proza nuk mund të shkruhej më si më parë dhe së dyti nuk mund të lexohej më si më parë, duke realizuar në veprat e tij ndërthurjen e harmonishme të eksperiencave të jashtme me një eksperiencë të brendshme për të parë aty refleksionet e një fenomenologjie me kahje nga jashtë-brenda dhe sidomos për të hetuar shtysat patologjike e morale të një rindërtimi e një ripërfjetimi të botës së jashtme me një kahje të ndryshuar nga brenda-jashtë.

Po kaq autoritet dhe përcaktues mbetet pozicioni i Kutelit dhe në fushën e mendimit ekonomik ku shfaqja serioze e veprave të tij në shqip e rumanisht dëshmon për pjekurinë dhe shumplanësinë e formimit të tij tepër intelektual, impakti pozitiv i të cilit është ndër në kontributin real që ka dhënë Mitrush Kuteli në krye të Bankës Shqiptare.

Synimi i ZA Pogradec përmes veprimtarive të tilla është përcjellja e mesazheve aq të domosdoshme për të sjellë në vëmendje të bashkëkohësve, modelin e qytetarit progresive për t'i thënë brezave të vazhdimërisë se modele të tilla janë pasqyra ku shëmbëllimi i gjithësecilit përmasohet dhe konvertohet në veprat që duhet t'i përfaqësojnë.

Kolosë të tillë na kanë lënë trashëgimni ne, të gjitha teknikat e tregimit të tyre, t'i lexojë intelektualit, punëtori, mësuesi, nxënësi, fëmija pasi për ta përcjellë dhe atje ku nuk "dëgjojnë".

Ju them të jeni të etur për diturinë dhe të vëmendshëm me mesazhin që do të merrni në këtë eveniment ku do të gjeni të materializuar edhe Kutelin prind përmes paraqitjes së materialit nga



fëmijët e tij, të cilët kanë ndjekur me përkushtim porosinë e testamentit. Porosi që çdo fëmijë duhet t'i dëgjojë nga prindërit e tij.

Do t'ju rekomandoja ta lexoni me vëmendje, sepse atje do të gjeni të aktualizuar ato veti të larta të shoqërisë njerëzore për të cilat ky komb ka më shumë nevojë se kurrë...

Mesazhi: "Ta duam vendin dhe gjuhën tonë, të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, Atdheu është Atdhe, bile dhe atëherë kur të vret", tingëllon aktual për të gjitha kohërat. Do ta gjejmë të ngjashmin e tij vite më vonë kur i madhi Kenedo do të slogonte shprehjen "Mos pyet çfarë bën vendi yt për ty, por çfarë do të bësh ti për vendin tënd" duke na tërhequr vëmendjen të gjithëve ne, ë këtë 100 vjetor të pavarësisë e në vazhdim çka vendi kërkon prej nesh që ta realizojmë, duhet të formësojmë vlerat më të larta të shoqërisë njerëzore për t'u bërë misionarët e saj.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen, vëmendjen e seriozitetin me të cilët do të ndiqni këtë veprimtari edhe një herë në emër të institucionit që unë përfaqësoj përkulem me respekt përpara veprës së Mitrushit të madh dhe ju them faleminderit.

Faleminderit pjesëtarëve të familjes Kuteli, faleminderit gjithashtu zotërinjve Plasari e Civici për përgjigjen e ftesës sonë.

Faleminderit zëvendësministrit të arsimit Z. Adrian Tane.

Faleminderit piktorëve të qytetit tonë Tasos, që ka peneluar veprën e madhe "Gjëma e mëkatit", Skëndit, Gentit, Vaskë Bashos për kontributin dhe ekspozitën e hapur në nderim të Kutelit të madh.

Faleminderit dhe le ta kujtojmë Kutelin e madh duke mësuar më shumë për të përmes kësaj veprimtarie!

Kuteli dhe eposi kutelian

(vijon nga faqja 2...)

Edhe ne jemi ende në këtë shoqëri. Mësimi që na jep Kuteli është që edhe në këtë shoqëri mund të guxohet të bëhet kritikë, edhe është e nevojshme madje e domosdoshme të bëhet kritikë. Në kritikën letrare, Kuteli na ofroi edhe modelin e portretit monografik. Mbeten unikale si modele prej të cilave mund të mësohet, me të cilat mund të imitohen dy portretet e tij, portreti monografik letrar për Lasgush Poradecin dhe ai për Fan Nolin. Janë, nuk po i quaj të papërsëritshëm, por janë trashëguar tashmë si modele në kritikën letrare shqiptare dhe në studimin e letërsisë shqipe. Por një element ndoshta i padukshëm që mund të mësohet nga kritika e Kutelit është ballafaqimi i kritikës së Kutelit me kohën. Sepse kritika ka një hile të madhe, kritikën ti e bën, e lëshon edhe ajo do përballet me kohën, nëse koha e vërteton kritikën tënde apo e hedh poshtë, ç'shkrimtar ke lavdëruar dhe ç'shkrimtar ke sharë; për këtë koha do të bëjë gjyqin qetë, pa zhurmë, por do të ta bëjë. Në letërsinë shqipe ne njohim edhe raste shkrimtarësh të mëdhenj që nuk janë dalluar ose që kanë dështuar me atë që kanë lavdëruar dhe me atë që kanë sharë. Nuk e di apo nënqesh prof. Samsuri se do thotë e di me kë e ke. E kam me të gjithë. Të gjithë ne ballafaqohemi me këtë sfidë të kohës ndaj kritikës që bëjmë.

Dy promovimet e mëdha që ka bërë Kuteli, po përmend dy ndër më të mëdhatë: promovimin e Lasgush Poradecit dhe promovimin e Nolit. Ne jemi të detyruar të dorëzohemi edhe të themi me gjithë polemikat, replikat, koha i dha të drejtë Kutelit dhe Kuteli ka dalë fitimtar. Kuteli doli fitimtar edhe ndaj sulmeve të Kris Malokut ndaj Lasgush Poradecit edhe ndaj sulmeve të Arshi Pipës për Fan Nolin me dyshimin që Fan Noli nuk është poet. Sot, ne, sigurisht i kemi të zhvendosura në hije teorizimet e Kris Malokut për Lasgushin dhe ato të Arshi Pipës për Fan Nolin dhe ka triumfuar shkencërisht promovimi që atyre u ka bërë Mitrush Kuteli, i cili mund të gjendet i sintetizuar edhe në një ese magjistrale, ese model që ndoshta ju e njihni dhe që titullohet "Poet dhe detar..", 1944. Kuteli si mësues letrar mund të na mësojë edhe nëse duam të konkurrojmë të përfshihemi edhe në publicistikë. Shembulli që ai na ofron mund të jetë ajo përmbledhje e pamfleteve të tij "Avadan më avadan". Një profil gati i papërsëritshëm i pamfletit social, ideologjik, po edhe politik. Mendoj që nën zhanrin e pamfletit askush tjetër nuk e ka konkurruar dot Mitrush Kutelin. Dhe parimisht ne në krijimtari duhet të themi ato zhanre ose nën zhanre ku dikush nuk është



konkurruar dot, janë për t'u ndjekur dhe për t'u imituar. Janë si zona të mbetura bosh, si zona me vakum, po në këtë fushë mësuesie në thonjëza ose edukimi, të cilën po përshkruajmë. Nga Kuteli nxjerrim mësimin sesi mund të bëhemi botues. Kuteli u bë dhe editor, aq sa pati mundësi me mundësitë e tij tejmase modeste, duke përfshirë edhe shpenzimet e xhepit të tij dhe borxhet që mori, por realizoi ato botime kryevepra dhe të pakonkurrueshme edhe më vonë të dy autorëve të mëdhenj duke kryer një detyrë kulturore. Dy vëllimet e përmbledhjeve të poezive të Lasgush Poradecit "Vallja e Yjve" 1933 dhe "Ylli i Zembrës" 1944. Mandej përmbledhja "Mall e brengë" e Fan Nolit. I pari libër original me krijime të Fan Nolit, i botuar në Shqipëri, Amerikë, kudo. Shembulli që na ofron Kuteli është botuesi në shërbim të kulturës dhe jo botuesi në shërbim të biznesit.

Të mos harrojmë që pa këto botime ne nuk jemi të sigurtë të themi që si do ishte sot marrëdhënia jonë me veprën e këtyre dy shkrimtarëve. Nëse Lasgushi, ndonjëherë përtac i madh, do t'i kishte botuar vetë të vetat, (por ai pothuajse nuk u mor), as Noli nuk do ishte kujtuar t'i mblidhte poezitë e veta po të mos kishte qënë hap i parë i përmbledhjes që konceptoi dhe realizoi Mitrush Kuteli.

Mësimi i dhënë nga Mitrush Kuteli në fushën e letërsisë mund ta nxjerrim nga marrëdhënia e tij me folklorin. Jo thjesht nga realizimi i përmbledhjes "Këngë e britma nga qyteti i djegur" (Pogradeci), ose qoftë edhe përmbledhja me proverba shqiptare të botuara në Rumani. Jo akti në vetvete, metodika që ka përdorur. Metodika që ka përdorur Kuteli tek "Këngë e britma nga qyteti i djegur" është një metodikë e cila edhe nga folkloristika pasardhëse shqiptare nuk u përfshi ose nuk u arrit dot për vetë paragjykimet në të cilat u punua. Kuteli, ju

e keni parasysh, shënon nga kush e ka marrë këngën, kur e ka marrë këngën, ç'personalitet ka personi që e ka kënduar, ç'arsim ka, ç'gjuhë të huaja di, ku ka bërë kurbet, ka bërë kurbet në Greqi, në Vllahi. Këngët i sjell era. Shumë më vonë studiues të shquar shqiptarë u morën me debatin e kotë dhe të zbrazët të qarkullimit të motiveve që ua kanë marrë shqiptarët filan populli apo është ai popull që ua ka marrë shqiptarëve. Është një debat kot, i zbrazët sepse teoritë moderne të folkloristikës i japin të drejtë Kutelit, pra rëndësi ka cilësia sesi një popull e riprodhon motivin, i cili mund të jetë i përbashkët edhe me shqiptarët edhe me banorët e Alaskës, edhe nuk është kjo çështja për t'u diskutuar. Shkenca moderne e folkloristikës në këtë fushë i ka dhënë të drejtë Kutelit. Por mësimin më të fundit dhe ndoshta më të rëndësishëm nga Kuteli në letërsi do duhet ta marrim nga marrëdhënia e tij me gjuhën.

Një marrëdhënie e jashtëzakonshme dhe një shekull i detyrueshëm për këdo që mendon, për këdo cilin e gënjen mendja që mund të shkruajë letërsi shqipe. Madje që të mos them në këtë rast marrëdhënie, se është term shumë i ftohtë, term zyrtar, financiar, bankar ndoshta, po e përdor siç e përdor vete Kuteli dhe Gogoli: të dhënë dhe të marrët. Ndoshta dhe ky është term që vjen nga financa. E treta: Modeli që na ofron Kuteli, përse i përket moralitetit qytetar, atdhetar. Kemi parasysh që dijet e sotme sociologjike ose sociologjia e letërsisë kanë saktësuar tanimë një konstatim që nuk mund të diskutohet. Te një shkrimtar moraliteti letrar dhe moraliteti qytetar jo gjithmonë përkojnë. Mund të jetë shkrimtar i talentuar, mund të jetë qytetar i madh; mund të jetë shkrimtar i talentuar, mund të jetë qytetar i vogël (meskin), i parëndësishëm. Rasti i Kutelit është rasti me fatlum i çdo letërsie, ku moraliteti letrar përkon me moralitetin qytetar dhe atdhetar.

Antifashizmi i Kutelit është i lexueshëm qartë, por dua të shtoj parimet e moralitetit qytetar e atdhetar si psh. për parimin ndaj atdheut, që Atdheu duhet dashur edhe kur të vret. Nuk ka arritur ta thotë asnjë shkrimtar tjetër në letërsinë shqipe këtë parim moraliteti qytetar dhe atdhetar tashmë, jo letrar. Populli njej parim tjetër shumë të rëndësishëm, i cili ka krijuar ndonjë vuajtje në letërsinë shqipe dhe te shkrimtarë me emër. Parimi që Kuteli formulon në këtë mënyrë: Unë kam pasur gjithnjë, si bir i një populli të vogël, një urrejtje të madhe kundër idesë së zezë "popuj mbi popuj" ose "të mëdhenj mbi të vegjël", por "popuj përkrah popujsh".

Kjo tezë e universalitetit qytetar i bën nder jo vetëm Mitrush Kutelit, por edhe letërsisë shqipe ku kjo tezë ka lindur dhe është formuluar.

Angazhohu Monitoro Vepru



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK, POGRADEC, QERSHOR 2012

Për më shumë se një votë në vendimmarrje

Për më shumë se një punë me honorar

Vijnë në kolona plot ngjarje,

“Monitorimi dhe Këshilli Bashkiak”



UNE EKZISTOJ, PRA JAM faqe 6

VARKAT E SHPËTIMIT - BIZNESET faqe 7

INTERVISTA faqe 8-9

NGA SPORTI NË SPORT..... faqe 10

MBLEDHJET E HAPURA, GOJËT E MBYLLURA
..... faqe 10-11

EDITORIAL

Monitorimi ynë vijon me raportet e vlerësimit edhe te ky numur buletini. Grupet e organizuara të vullnetarëve - aktivistë të shoqatës “Unë, Gruaja” për mbikqyrjen e mbledhjeve të këshillit bashkiak, vijnë me shkrime analitike, diku edhe këshillimore apo opinioniste, të hapur jo vetëm për lançimin e strukturuar të diskutimeve dhe bisedimeve pro qytetarëve gjatë mbledhjeve, por edhe për të shprehur modestisht reflektimet e tyre mbi çështjet problematike, natyrisht pas votimit të tyre nga ana e përfaqësuesve tanë, anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Kolonave të botimit tonë i shtohet këtë numër edhe shkrimi i z. Dhimitër Gegprifti, një gazetar - monitorues me eksperiencë disa vjeçare, i cili jo vetëm frymëzon të rinjtë aktivistë, por edhe shkëmben me ta përvojën vetjake dhe dobitë e profesionit.

Në brendësi të Buletinit ANGAZHOTHU – MONITORO -VEPRO, numri 4, trajtohen

çështje, si: Bizneset - Varkat e Shpëtimit; Kalimi i Fondit të KS Pogradeci te Klubi Shumësportësh; Kompetencat e Këshillit Bashkiak; Prezantimi i Shoqatës “Unë, Gruaja” në Panairin “Bëj të dëgjohet zëri yt!”, Tiranë;

Dhe së fundmi, si gjithmonë, një quiz me pjesë mohuese dhe pohuese, për të testuar informimin mbarëqytetar mbi kompetencat e Këshillit Bashkiak, Pogradec.

Kryeredaktor: Dorian Leka



**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN
12 DHE MERRNI NJË DHURATË
NGA GRUPI MONITORUES**

**Monitorimi
i Këshillit
Bashkiak,
Pogradec
Dosja Nr. 4,
Qershor 2012**



Unë EKZISTOJ, pra JAM

MARIGLEN VRETO

Unë ekzistoj, pra unë jam, sikurse unë dhe të gjithë bashkëkombasit tanë në të gjithë vendin. Në të njëjtin vend që na rriti dhe na edukoi të bëhemi qytetarë të denjë të kësaj shoqërie. Një shoqëri e cila ka ndërmarrë në periudha kaq të shkurtra ndryshime kaq të mëdha, një shoqëri e cila ka në embrionin e saj dëshirën për ndryshim. Kjo ishte arsyeja pse z. Ambasador e shtyu i mahnitur mbase edhe nga populli shqiptar për të ndërmarrë një nismë e cila ka në themelet e saj, ka bujarinë e popullit tonë mik amerikan që nëpërmjet USAID dhe kujdesin e ambasadës amerikane në Tiranë të ndërmarrin nismën VEPRO TANI. Ishte kjo nismë që solli në Tiranë shoqata dhe OJQ më në zë të vendit, mes tyre edhe shoqatën 'UNE GRUAJA'.


Për ne, grupin e monitorimeve, ishte një eksperiencë nga më të jashtëzakonshmet dhe që besoj se na motivoi akoma edhe më shumë në misionin tonë dhe kontributin e metejshëm në demokratizimin e shoqërisë. Një shoqëri e përdhosur, e indoktrinuar, e frikësuar nga autoritarizmi politik ndër vite, por që po gjen kurajo dhe po arrin të krijojë guaskën e vet

përballë mediokritetit. Mbase për herë të parë në jetën time jam ndjerë krenar që jam pjesë e kësaj shoqërie kur kuptoj se ka edhe të tjerë si unë, si ne. Ndihe mi si një familje e vetme kur shikoj që na rrethojnë dhe shume organizata të tjera në panairin e organizuar me aq përkudësje nga Ambasada Amerikane përballë Galerisë së Arteve.

Më vjen në mendje një thënie që vazhdon të jetë akoma aktuale: "Mos pyesni se ç' mund të bëjë Amerika për ju, po se çfarë jeni në gjëndje të bëni ju për Amerikën!" - shkëputur nga një fjalim i presidentit të ndjerë Xhon Kenedy drejtuar popullit amerikan. Mbase ky është edhe mesazhi që do të donte të përçonte zoti ambasador i Shteteve të Bashkuara, z. Arvizu, me nismën e ndërmarrë së fundmi dhe që ne besojmë se do të ketë sukses. Është bërë tashmë një traditë që ambasadorët e akredituar në Shqipëri, sidomos ata amerikanë, mësojnë të jetojnë si shqiptarë, mbase të lumtur se gjejnë njerëz që ju buzëqeshin, kudo që ata shkojnë, gjejnë shqiptarë të përvuajtur, por që me bujarinë dhe si me magji të bëjnë për vete dhe të nxisin për t' u bërë pjesë e rrugës së tyre drejt mirëqënies dhe prosperitetit. Kështu m' u duk edhe mua në fjalimin e mbajtur brenda ambienteve të Galerisë së Arteve, nga ku z. Arvizu shpalsi projektin. Aty mund të kuptoje sesi një amerikan mund të shqiptarizohet dhe përpiqet të kontribuojë për shoqërinë në të cilën ai gjen dhe veten e tij.

Mbase në jemi mësuar t' i shikojmë këto personazhe nga kutia e vogël e televizionit, por që me të drejtë aty arrije të ndjeje dhe të kuptoje më natyrshëm individin.

Në këtë nismë "UNË, GRUAJA" përfaqësoheshe me punën shumë vjeçare me



projekte të implementuara tashmë rezultative në rajonin e Pogradecit por dhe me gjerë. Ishte grupi ynë Alda, Ledi, Doralda, Ligerta, Xhensila, etj që prezantonin shoqatën me projektet e ndërmarrta ndër vite nga kjo shoqatë, me promovimin e vlerave turistike, të traditës pogradecare, në zhvillimin dhe emancipimin e gruas pogradecare, nëpërmjet projekteve dhe trajnimeve dhe shumë e shumë projekteve të tjera, të cilat morën vëmendjen e të gjithë të pranishmëve dhe të kalimtarëve, të cilët të tërhequr nga kureshtja rendnin për të pyetur grupin për aktivitetin e shoqatës dhe për Pogradecin, që tashmë ka kaluar kufijtë e vet falë dhe promovimit të shoqatës sonë dhe kontributit të të gjithë qytetarëve të Pogradecit. Në fytyrat e vajzave dhe djemve të grupit dallohej qartë gëzimi.

Tenda jonë u vizitua edhe nga diplomatë të lartë, të akredituar në Tiranë dhe që në fund kulmoi me ardhjen e z. Arvizu, për të cilin grupi kishte menduar t' i bënte një dhurate, atë me të bukurën: librin. Një libër ndër të shumtat botime të shoqatës, me dedikim nga grupi ynë. Le të shpresojmë se z. ambasador do të mësojë të lexojë shqip ndonjë ditë! - themi ne me buzën në gaz. Po nuk ka dhe shumë rëndësi, e rëndësishme është se ne u përpoqëm të kryenim misionin tonë të shqiptarit, ta bëjmë të ndihet si në shtëpinë e tij çdo të huaj dhe besoj se ja arritëm qëllimit.



“Varkat e shpëtimit - BIZNESET”

DORIAN LEKA



“Sot më duhej t’i ndaja sërish paret e kafesë me një lypës, i cili më ka mësuar kohët e fundit edhe emrin. Jemi bërë shokë. Përgjithësisht, kur nuk e shoh atë, 20 lekshin e lë bakshish për kamerierin. Ka raste kur edhe ia kursej djalit të tezes, i cili ka dalë në kemp dhe ndihma që merr e ka shtyrë jashtë vullnetit të kërkojë ndonjë punë në të zezë, megjithëse është i vetëdijshëm se nuk zotëron ndonjë potencial të mundshëm për të qenë i dobishëm diku’.

Duke menduar si të reflektoj mbi mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2012, specifikisht për projekt - vendimin: “Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për periudhën 1 Maj - 31 maj 2012”, zgjedha të ndaj me ju një mikro-gjest të papërfillshëm bamirësie, natyrisht brenda limiteve të modestisë nga ana ime, për të bërë një parantezë rreth kontributeve që u janë kërkuar

bizneseve gjatë një takimi me kryetarin e Bashkisë, z. Artan Shkëmbi dhe më pas nga anëtarja e këshillit të Bashkisë, znj. Mimoza Shuli, e cila para se të fillonte leximi i rendit të ditës, deklaroi se: *“...e shtyrë nga takimi që kryetari i Bashkisë bëri me bizneset aktuale në Pogradec, për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, pagesën time si anëtare e Këshillit Bashkiak, që nga janari e deri në qershor, do ta jap si kontribut për këto familje’.*

Jetojmë në ditë të vështira... Nga numri i kaluar i suplementit tonë mbaj mend edhe një frazë të këshilltarit Guri Ademaj dhe mësuese Natalias (po këshilltare në Këshillin Bashkiak), të cilët, kur u ngritën pretendimet nga drejtori Ilir Mimini i ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime Pogradec, thanë: *“Përse duhet të vijë puna deri te rritja e çmimit, kur momentalisht jemi në një situatë të mjerueshme papunësie dhe varfërie?”.*

Mesa duket, të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak janë të ndërgjegjshëm për krizën që, kur kaploi një botë, natyrisht s’kishte si ta kursente dhe një provincë të vogël si e jona, por cilat janë projekt - vendimet, masat, rekomandimet, udhëzimet, planet... dhe një pafundësi sugjerimesh që secili prej tyre duhet të

ndërmarrë në funksion të përpjekjes së lehtësimit (në pamundësi të kurimit) për këtë sindromë që sa vjen edhe po rëndohet në familjet tona?!

A do ta nxirrte nga bataku situatën aktuale ekonomike një takim i singertë dhe i hapur me bizneset, apo qoftë edhe një rrogë disamujore e këshilltares së nderuar? Edhe sikur bizneset të ishin në kohën e tyre të artë, edhe sikur kryetari të punësonte dyfishin e stafit aktual të bashkisë, edhe sikur të gjithë këshilltarët të ndiqnin shembullin dinjitoz dhe altruist të zonjës Mimoza Shuli, a do të sillte kjo një ndryshim të konsiderueshëm për nevojtarët e ndihmës ekonomike...?!

Nëse ju rrëfej se cilët janë fajtorët (mëkatarët) e kësaj situatë, sipas opinionit tim, kam frikë se do keqkuptoheshim, por nuk mund të mos ndaj me ju disa rekomandime në formë konstatimesh, të cilat besoj se s’duhen anashkaluar:

- Përplasja e krahëve të kundërt politikë ndërmjet qendrës (qeverisë) dhe vendorit (bashkisë tonë) për ndarjen e buxhetit, nuk ka të njëjtin efekt si polet e kundërt të magnetit.

- Anëtarët e Këshillit Bashkiak, pjesërisht tundin “kartonët e vendimmarrjes” për të përshpejtuar procesin i cili ju gjymton kohën, duke e pasuruar atë gjetiu, në vend që të krijojnë të preokupuar disa kura të favorshme për varfërinë aktuale.

- Figurojnë disa shoqata enigmatike në qytetin tonë, që pas vjeljes së fondeve fashiten si meteorë titanë në vrimat e zeza (duke përjashtuar këtu shoqatën më aktive dhe pranë qytetarëve “Unë, Gruaja”, aktivitetet e të cilës kanë mbetur jetime në vorbullën e simotrave të saj bashkëqytetare, me seli në Pogradec, apo kudo qofshin).

- E shumë fajtorë të tjerë që, ose kanë probleme me thirrjen humane të ndërgjegjjes, ose kanë deficencë të kësaj të fundit.

Le të jenë idetë dhe projektet e ndryshme si: punësimet sezonale, kreditë e vogla apo “të buta”, përgjysmimet e çmimeve nga mallrat stok në dyqane, bujaria në sasinë e buxhetit (të paktën njeherë të vetme) nga ana e qeverisë sonë, ato që duhet të pushtojnë foltoret e diskutimit dhe debatit të ashpër nga ana e vendimmarrësve tanë.



Këshilli Bashkiak dhe pretendimet e UK-Pogradec

Intervistë me z. **Avdullah Cano**, anëtar i Këshillit Bashkiak, Pogradec

1- Si anëtar i Këshillit Bashkiak, Pogradec, mund të na sqaroni shkurtimisht qëndrimin tuaj mbi debatet e ashpra të mbledhjes së datës 02.05.2012?

Para se t'ju përgjigjem, do të më lejonit, që me shumë dashamirësi t'u përgëzoja për atë ç'ka jeni, duke ardhur në dobi të një informimi dhe sensibilizimi sa më të gjerë të bashkëqytetarëve tanë, përmes një gjetjeje kaq të veçantë, si kjo e juaja, ku motoja e suplementit tuaj 'Angazhohu – Monitoro – Vepro' ngjan më tepër me një thirrje të hapur drejtuar qytetarëve, për t'u bërë pjesë e vendimmarrjeve, të cilat vijnë përmes qëndrimeve të mbajtura nga përfaqësuesit e tyre në Këshillin e Bashkisë. Është vërtet mirë, që një grup të rinjsh si ky i juaji, bëhet inspirues i një sipërmarrjeje të tillë. Ndaj edhe njëherë do të doja t'ju falënderoja, ju dhe bashkëpunëtorët tuaj, për këtë nismë, të cilës do t'i uroja shumë sukses dhe jetë të gjatë.

Po kthehem te pyetja juaj. Në mbledhjen e datës 02.05.2012 të Këshillit Bashkiak, pika më e debatuar e rendit të ditës, padyshim ishte ajo që kishte të bënte me një material të paraqitur nga Ujësjellës Kanalizime, sh.a. Pogradec. Më duhet të kujtoj se një mbledhje para kësaj, u paraqit një projekt-vendim i UK-së Pogradec me propozime për rritje të tarifave të ujit të pijshëm dhe ujrave të përdorura, projekt-



vendim, i cili nuk u votua. Nga këshilltarët u sugjerua që në takimin e radhës, nga përfaqësuesit e UK-së të sillen një informacion më i plotë, me vlera të llogaritura veçmas për Bashkinë Pogradec dhe Komunën Buçimas, si dy njësi administrative që përftojnë këto lloj shërbimesh nga UK sh.a. Pogradec. Ky material, edhe pse ishte shumë voluminoz e me detaje pafund (një pjesë e madhe e tyre e panevojshme), nuk ndihmoi sa duhet në qartësimin e këshilltarëve, për të bërë një vendimmarrje pozitive në mbështetje të projekt-vendimit të paraqitur. Sigurisht që debati (ndonjëherë edhe me tone të larta) ishte plotësisht i justifikuar, pasi duhet të dimë se këto lloj vendimmarrjesh prekin në menyrë të drejtpërdrejtë interesat e qytetarëve. Jo rrallë për çështje të tilla diskutimet në Këshillin e Bashkisë kalojnë në debate e argumenta të tejzgjatura, ku një pjesë e vogël e kolegëve këshilltarë, duke shfrytëzuar dhe prezencën e mediave lokale, përpiqen t'i japin ngrime politike problemeve, sigurisht duke menduar se kështu kanë ndikuar

tek mbështetësit e tyre. Kam krijuar bindjen, falë edhe përvojës sime të gjatë në Këshillin e Bashkisë, se gjithsecili prej nesh do të duhej të ishte po aq i impenjuar dhe kontributor për të gjitha problematikat, që vijnë si zgjidhje përmes projekt-vendimeve të votuara prej tyre, duke anashkaluar vendimmarrjet e ndikuara politikisht dhe për interesa të momentit.

2- Në mbledhje u kërkuar nga këshilltarët të ndryshohet organizimi dhe të përmirësohet struktura e UK-së. Po ju, i bashkoheni këtij propozimi?

Nëse keni qenë të vëmendshëm në rolin tuaj si monitorues, në këtë mbledhje u përmend se UK sh.a. Pogradec ka patur rendiment të lartë në menyrën sesi është administruar, madje një nga më të mirët në vend. Nëse mbajmë parasysh faktin se këto dy projekte (i ujit të pijshëm dhe atyre të përdorura) janë realizuar me mbështetjen dhe financimin e donatorëve (KFW, BE dhe Qeveria shqiptare) duhen marrë në

konsideratë dhe kushtet e vendosura prej tyre, ndër të cilat më të rëndësishmet janë ato që kanë të bëjnë me:

- Rritjen e nivelit të arkëtimeve
- Reduktimin e numrit të punonjësve
- Minimizimin e humbjeve në rrjetin shpërndarës së ujit të pijshëm, etj.

Gjykoj se nëse përmbushja e këtyre kondicioneve të vendosura prej donatorëve do të ndikohej prej një ndërhyrje në strukturën e UK-së (gjë që s'më duket se është kështu), sigurisht që kjo do të mjaftonte jo vetëm për mua, po edhe për shumë kolegë të mi këshilltarë, që ta mbështesnim një propozim të tillë. Gjithsesi druaj se problemet që shtrohen për zgjidhje janë disi më ndryshe (si më të vështirën shikoj uljen e humbjeve në rrjetin e ujit të pijshëm), të cilat kërkojnë më tepër vëmendje dhe ndërtim strategjish afatgjata të menaxhimit, që në definicion do ta bënin UK sh.a. një strukturë ekonomike rentabël.

3- Ndryshimi i tarifave dhe faturave ishte objekti kryesor i kundërshtimit të përfaqësuesve të UK-së, ju si e arsyetoni votimin tuaj në këtë pikë?

Këmbëngulja e ime përmes pyetjeve, apo edhe në diskutime, kishte të bënte jo vetëm me rritjen e tarifave, por me rritjen e diferencuar të tyre për kategori të ndryshme të konsumatorëve (uji i pijshëm) apo klientëve (ujrat e përdorura), të cilat respektivisht rriten (sipas propozimit) me 5 dhe

INTERVISTË

Këshilli Bashkiak dhe pretendimet e UK-Pogradec

D. LEKA

15 lekë për m³, propozim i cili do të mund të merrte mbështetjen e gjithë grupit të këshilltarëve, nëse shifrat do të ishin më të kursyera. Sigurisht që në përfundim të gjithë asaj maratone pyetje-përgjigje e diskutime, duke qënë i bindur se propozimi i UK-së, është në logjikën e gjithë atyre proceseve që ndodhin në dinamikën e një shoqërie në evoluim, po edhe duke e lidhur gjykimin tim me vazhdimësinë e fazës përmblylëse të këtij projekti tejet të rëndësishëm për komunitetin ku dhe ne jetojmë, e gjeta me vend që ta votoja këtë propozim. Askush prej nesh nuk do ta besonte se me këtë rritje tarifore UK-ja do të mund t'ja dilte mbanë duke mbuluar kostot dhe deficitet e krijuara nga humbjet në rrjetin shpërndarës dhe atë të arkëtimeve, por siç dhe e kam cituar edhe më lart, situata kërkon ndërhyrje të mirëmenduara e që ofrojnë zgjidhje afatgjata. Kur them kështu, nuk jam duke bërë me faj askënd, por me dashmirësi, njëherazi si një detyrim moral i një përfaqësuesi qytetar, do të dëshiroja që sa më shpejt të ishte e mundur, të siguroheshin zgjidhje të tilla që do të garantonin shfrytëzimin në kapacitete të plota të këtyre dy investimeve, që janë nga më të mëdhatë në shkallë vendi. Me pak fjalë, ne, komuniteti ynë, është vërtet me fat, që përmes këtyre dy projekteve (që tashmë janë të padukshme, nën tokë) ka garantuar 24 orë ujë të pijshëm një liqen të pastër, si dhe një mundësi të maksimizuar për turizmin.

Intervistë me z. Avdullah Cano, anëtar i Këshillit Bashkiak, Pogradec

4- *Cila është arsyeja që Këshilli Bashkiak rrëzoi propozimin (apo dha mospëlqimin) e UK, Pogradec dhe cilat janë pasojat, apo në rast të kundërt, përfitimet e këtij refuzimi?*

Është e vërtetë se propozimi nuk arriti të merrte mbështetjen e shumicës së këshilltarëve. Gjithësesi, prej këshilltarëve u kërkuar që nga UK-ja të sillen një informacion në mbledhjen e radhës, si dhe propozimi të konsultohet nga këshilli mbikqyrës i UK-së. Duke ju referuar pyetjes tuaj do të shtoja, se nuk bëhet fjalë për pasojat apo përfitime, por për një mundësi, për ta studiuar problemin më thellë, për të sugjeruar dhe ofruar zgjidhje që do të mundësonin një situatë pozitive dhe të qëndrueshme financiare tek

institucionalë'. Ndërkohë që morët përgjigjen nga përfaqësuesit e UK-së: '...ne po shkojmë në logjikën e barazimit të ëmimeve.'

Do të më falni që për një pyetje kaq të gjatë nuk mund të jap një përgjigje të tillë. Ajo që më shtyu ta bëja një pyetje të tillë kishte të bënte me faktin, se në tarifat e propozuara vërejtja një dipropozicion në rritjen në përqindje për kategori të ndryshme të konsumatorëve. E gjithë kjo, nuk do të thotë se jam në një linjë, apo i dakorduar me përgjigjen e dhënë nga përfaqësuesit e UK-së.

5.1 - *A ishte kjo përgjigja që prisnit?*

Jo.

5.2 - *Atëherë, cili ishte qëllimi i pyetjes suaj?*

favorizim të konsumatorëve familjarë në raport me dy kategoritë e tjera (në fakt ky ishte dhe qëllimi i pyetjes), ndryshe nëse i unifikojmë në tarifa të tre kategoritë e konsumatorëve, ç'kuptim do të kishte që të vazhdojmë të specifikojmë klientët apo konsumatorët, të ndarë në disa kategori.

6- *Propozimi juaj gjatë mbledhjes ishte: 'Të ndikojmë me përfaqësuesit tonë në Këshillin Mbikqyrës, që t'i ndihmojmë ta superojnë këtë situatë.'* - *A diskutuat me përfaqësuesit tuaj dhe cfarë mund të bëjnë ata për të realizuar propozimet tuaja, të cilat bien ndesh me ato të UK-së, Pogradec?*

Përfaqësuesit tanë në Bordin e UK-së apo në Këshillin Mbikqyrës, nuk mund të sillen në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë njëloj si gjithë të tjerët. Ata tashmë kanë një mandat përfaqësuesi dhe gjithë argumentat, sugjerimet dhe propozimet e bëra prej kolegëve këshilltarë, do të duhet t'i bëjnë pjesë të vendimmarrjeve të këtij organizmi, në funksion të shëndoshjes së situatës në UK sh.a. Pogradec, në përmbushje të kondicioneve të diktuar prej donatorëve, po edhe në garantimin e qëndrueshëm dhe cilësisht më të mirë të këtyre shërbimeve tejet të domosdoshme e jetësore për qytetarët tanë.



UK sh.a. Pogradec. Kam bindjen se në një nga mbledhjet e tij të radhës, kur çdo gjë do të jetë më e qartë për secilin prej nesh, propozimet e UK-së do të kalojnë.

5- *Pyetja e ngritur nga ju për drejtorin e UK-së, z. Ilir Mimini, ishte: 'Pse dhe si ndryshon tarifa e konsumatorëve familjarë, nga konsumatorët privatë dhe*

Nxitjen për pyetjen e mora prej asaj difference që ekzistonte në rritjen e tarifave midis kategorisë së konsumatorëve familjarë, krahasuar me kategoritë e konsumatorëve institucionalë dhe klientë privatë. Në gjykimin tim, nuk do ta shikoja me vend që të aplikohen tarifa të njëhësuar për kategori të ndryshme të klientëve. Pa asnjë mëdyshje, jam për

*Intervistoi: Dorian Leka
Pogradec më, 14/06/2012*

Mbi TARIFAT e UK-Pogradec dhe PËLQIMIN e Këshillit Bashkiak”

Ledjan Zeqollari

Duke u nisur nga këndvështrimi i së njëjtës çështje të ngritur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak “Për rritjen e tarifës së ujit të pijshëm”, e cila është pasqyruar në intervistën me drejtorin e UK sh.a, z.Illir Mimini dhe z.Avdulla Cano, anëtar i Këshillit të Bashkisë, duke i vlerësuar për arsyetimin e saktë logjik dhe ligjor njëkohësisht, dal në opinionin se: kjo çështje e trajtuar në atë mbledhje krijoi një debat, i cili ne si grup monitoruesish na detyroi ta shikonim më gjatë. Duke e parë me syrin e një qytetari, ashtu siç do të donte ta shikonte çdo individ i thjeshtë, i cili “pagan për të shuar etjen” pa hyrë në detaje të cilat nuk janë në kompetencën e tij, do doja ta shikoja këtë problem në mënyrë më të drejtpërdrejtë, duke bërë kështu avokatin e qytetarit.

Ne të gjithë jetojmë në një ekonomi tregu, duke e ditur shumë mirë që konsumi dhe shërbimet detyrimisht duhet të paguhen. Por jo të gjithë e kanë këtë mundësi, ose më saktë i bëjnë ballë rritjes së një tarife për një shërbim të caktuar, në rastin tonë tarifa e ujit të pijshëm. Ky ndryshim duhet të ndikojë butësisht te qytetarët, për të qenë i përbalueshëm për ato familje me të ardhura të vogla, apo ato që janë me ndihmë ekonomike. Është e vërtetë që ndërmarrja e UK, ka bërë një punë për t’u lavdëruar për furnizimin me ujë të pijshëm 24-orë, pasi ky shërbim iu ofrohet pak qyteteve

në Shqipëri. Por nga ana tjetër qytetarët duhet të përballen me rritjen e tarifës, gjë e cila është e pamundur për nivelin e jetesës. Ky problem u ngrit edhe në mbledhjen e këshillit, ku sipas disa anëtarëve, qytetarët sot po përballen me rritjen e çmimeve dhe me papunësinë dhe kjo rritje është pikërisht në momentin e gabuar. Ky arsyesim i drejtë sipas tyre solli edhe votimin kundër këtij projekt- vendimi. Zgjidhja më e mire do të ishte që në bazë të rrugëve ligjore ky projekt –vendim, të shikohej edhe njëherë, si mundësi e mirë për të gjetur një gjuhë të përbashkët, e cila duhet të flitej në vendin ku degjohet, vendoset për qytetin dhe qytetarin, në Këshillin e Bashkisë. Para se rritja e tarifës të bëhet e mundshme duhet bërë më mirë rishikimi i shkeljeve apo abuzimeve të tjera, pasi shumë konsumatorë “pagojnë” edhe për ata të cilët shkaktojnë këto dëmtime në rrjet. Siç u tha edhe më lart, përmirësimi i shërbimit justifikon edhe rritjen e çmimit të ujit, por përmirësimi i jetës në një mjedis të përbashkët qytetar arrihet nëpërmjet një kompromisi ndërmjet insitucioneve dhe mundësive të qytetarëve. Nëse do të arrihej një zgjidhje e cila do të harmonizonte të dyja palët, si konsumatorët ashtu dhe institucionin përkatës, kjo do të shërbente në mbarëvjtjen e mëtejshme të punës dhe në zgjidhjen e problemeve.

MBLEDHJET E HAPURA, GOJËT E MBYLLURA

Dhimitër Gegprifti

Një nga veçoritë dalluese të mbledhje të zakonshme të Këshillit Bashkiak dhe Komunar është: ato janë të hapura, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur është parashikuar të zhvillohen të mbylluara, pa prani as dhe të mediave. Pse është parashikuar që ato të zhvillohen si të tilla? Përgjigjja është e thjeshtë: të eliminohen mbledhjet rutinë, pa bukë, pa bereqet, që bëhen sa për të kaluar radhën. Dhe raste të tilla ka jo pak. Ngrihen kartona apo duar dhe për të gjitha “amin”! Në to nuk është i pranishëm opinionin i gjerë qytetar, mungon shqetësimi dhe debate, vihet re një farë konformizmi. Por duhet theksuar se këto lloje mbledhjesh janë gjithmonë nën kontrollin e komunitetit të gjerë, realizohet në një farë mase edhe tansparenca. Njëherësh na duhet të nënvizojmë, se komuniteti në të gjitha këto raste mbetet vëzhgues, soditës dhe pasiv, si thotë populli gojëmbullur. Atëherë mund të themi: “të hapura”, por me gojë të mbyllura” Nëse do të bënim një krahasim pak vulgar: si në disa institucione, ku është vënë orari i pritjes, por dyert janë mbyllur, në disa aktivitete dhe shërbime është lënë tabela “hapur”, por aktiviteti është i mbyllur. Komuniteti në një farë mase është i informuar për natyrën e këtyre mbledhjeve, problematikat e tyre, por në të shumtën e rasteve, të shprehur në përqindje mbi 90% nuk sheh pjesëmarrës nga komuniteti, vetëm në ndonjë rast, kur lidhet me ndonjë kërkesë personale, mund të shohësh aktivistë, që kryejnë rolin e monitoruesit nga Shoqëria

vijon në faqen 11 →



Nga SPORTI në SPORT

Reflektimi mbi pikën e dytë të rendit të ditës: «Projekt-vendimi për prishjen / likuidimin e shoqërisë së futbollit 'KS Pogradeci' sh.a», gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 30.05.2012.

Klubi Sportiv Pogradeci, është një nga klubet e para shqiptare futbollistike, themeluar në vitin 1932. Që nga themelimi, KS Pogradeci, ka arritur të fitojë tri herë Kategorinë e Parë dhe 1 herë Kategorinë e Dytë. Edhe pse Liqenorët u dënuan për lojën e tyre të dobët në këtë kampionat, duke u larguar nga Superliga, pas një dështimi të kritikuar nga analistët e futbollit të Shqipërisë, përsëri, Bashkia e Pogradecit nuk e bëri një gjë të tillë. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak u propozua: Prishja / likuidimi i shoqërisë së futbollit 'KS Pogradeci' sh.a, fillimi i procedurave të likuidimit dhe përcaktimi i likuiduesit nga ana e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë, në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve.

Në mbështetje të nenit 32, shkronja 'd' e ligjit nr 8652, datë 31.07.2000 'Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore' (i ndryshuar), si dhe të nenit 187, pikës 1, shkronjës 'b' të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, duke e kaluar kështu, klubin e futbollit 'KF Pogradeci' në 'Klubin Shumësportësh'.

Ky vendim çoi në ndryshimin e Buxhetit të



Bashkisë Pogradec për vitin 2012, duke pakësuar zërin e kontributeve për 'KF Pogradec' sh.a, në tabelën e shpenzimeve të tjera për vlerën 11.963.482 lekë dhe ta shtojë zërin 'shpenzime futbollit' në tabelën e planit të shpenzimeve për 'Klubin Shumësportësh'. Me pak fjalë, *kjo vlerë shkon nga sporti në sport, kur Bashkia mund ta përdorë këtë fond në zëra të tjerë shpenzimesh, gjithmonë në ndihmë të qytetarëve, dhe jo vetëm për sportin.* – sipas prononcimit të disa këshilltarëve bashkiakë. Por natyrisht, kësaj kryetari do t'i përgjigjej se pika kryesore e programit të tij elektoral ishte sporti dhe progresi i këtij të fundit, paçka se me dështimin e pritshmërive nga futbollit, do të jetë e vështirë të realizohet.

Jemi në pritje të publikimit të një strategjie të re mbi zhvillimin e sportit nga ana e bashkisë, për buxhetin e vitit të ardhshëm, e cila tashmë është shprehur dukshëm në mbështetjen morale dhe financiare të sporteve. Por, këto pyetje shpresojmë të gjejnë përgjigje së shpejti, nga një intervistë që do t'i drejtohet kryetarit të bashkisë z. Artan Shkëmbi, i cili vetëm pak ditë më parë është prononcuar në media se '...nuk e ndjek më sportin shqiptar'. A do të mundet vallë një kryebashkiak i dashuruar me sportin, të hedhë tutje klubin sportiv të qytetit të tij dhe gjithë investimet në të.. ?

Denada Mani



MBLEDHJET E HAPURA, GOJËT E MBYLLURA

vijon nga faqja 10

Civile, por edhe kur është duke u realizuar ndonjë projekt me temë nga Pushteti Vendor, si: Buxhetimi me pjesëmarrje, për një qeverisje të mirë, ku shkojnë parat tona, gruaja në vendimmarrje, performanca e Këshillit e ndonjë tjetër.

Projekte të tilla e kanë bazën juridike në legjislacionin shqiptar, por dhe një mbështetje të gjerë financiare nga institucione ndërkombëtare. Në të gjitha mbledhjet me siguri shikon punonjës të administratës dhe ata jo të gjithë, por ata, që kanë ndonjë informacion ose të shpjegojnë diçka nëse u kërkohen nga rendi i ditës. Monitorimi nga Shoqëria Civile në kuadër të projekteve është përqëndruar kryesisht në Bashki dhe aspak në Komuna. A nuk do të ishte më produktiv projekti në shtrihej dhe realizohej në Bashki dhe në një apo dy komuna, pasi duket sikur ato nuk kanë probleme, i realizojnë më mirë funksionet sipas "Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal", por edhe ndër to ka jo pak problem. Përsëri vihet re një indiferentizëm i theksuar i komunitetit. Pse ndodh kjo? Ku e ka burimin? Nga sa kemi monitoruar në vite, kemi arritur në përfundimin se pushtetarët tanë nuk i parapëlqejnë këto lloj mbledhjesh, duke shprehur këtë qëndrim në forma të ndryshme, në ndonjë rast dhe duke u bërë pengesë serioze. Komuniteti, Shoqëria Civile shihet si e tepërt, duke i parë nga "lartësia" e pushtetit dhe harrojnë se ata i sollën në Pushtet. Akoma më i rëndësishëm është fakti se për këto mbledhje tregohet shumë pak kujdes për përgatitjen e tyre: nga tematika e rendit të ditës, nga numri i tyre, sa dhe si do t'u jepet mundësia të shprehen, koha në dispozicion, rregulli, radha e të tjera. Reklama, që u bëhet këtyre mbledhjeve: nuk do të mjaftonte vetëm një afishim në një vend publik. Mundësisht në të gjitha lagjet dhe të përmbajë detaje, po kështu në televizionin lokal e tjera. Por edhe në këtë rast dhe aspekt kërkohet vlerësim dhe një përgatitje serioze, ku vërtet do të realizohen kërkesat ligjore dhe shoqërore për të rritur gjithnjë e më shumë performancën e Këshillave Bashkiakë dhe Komunarë si organe me rëndësi në vendimmarrje, ku realizohet në praktikë dhe konkretisht transparenca, ku dëgjohet zëri i qytetarit, ku realizohet qëllimi final, që ato vërtet janë të hapura për ta dhe për publikun e gjerë.

QUIZ

Ky pyetësor synon të testojë informimin e qytetarëve për kompetencat e Këshillit Bashkiak

Zgjidh alternativën e duhur, PO ose JO duke shënuar kadratin

(Shkëputur nga Neni 32 i Ligjit për Qeverisjen Vendore)

KËSHILLI KOMUNAL OSE BASHKIAK KA KËTO DETYRA DHE KOMPETENCA:

__ Miraton statusin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.

PO JO

__ Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.

PO JO

__ Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e komunës ose bashkisë.

PO JO

__ Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit komunal apo bashkiak.

PO JO

__ Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PO JO

__ Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregëtare, si dhe të personave të tjerë juridikë, që krijojnë vetë ose është bashkëthemelues.

PO JO

__ Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.

PO JO

__ Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

PO JO

__ Organizon dhe mbikqyr kontrollin e brendshëm të komunës ose bashkisë.

PO JO

__ Vendos për tatimet, si dhe për nivelin e tyre.

PO JO

__ Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj palëve.

PO JO

__ Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes qendrore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta, ose me persona të tretë.

PO JO

__ Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së institucioneve publike, që funksionojnë në bashkinë apo komunën përkatëse.

PO JO

__ Zgjedh përfaqësuesit e këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut.

PO JO

__ Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.

PO JO

__ Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

PO JO

__ Vendos për simbolet e komunës ose bashkisë.

PO JO

__ Vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucionit dhe objekteve në juridiksionin e komunës, bashkisë apo qeverisë.

PO JO

__ Jep tituj nderi dhe stimuj.

PO JO

__ Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia.

PO JO

SHPERBLIMI

Personat që paraqitën pyetësorin e plotësuar në mënyrë korrekte janë Ida Lalaj dhe Albina Pajo, që shpërblehen përkatësisht me një libër “Komo” dhe një revistë “Poeteka” nga grupi ynë i monitorimit. Dorëzimi i pyetësorit bëhet tek zyra e shoqatës “Unë, Gruaja”. tel: 083222140

Dr. Ardian Civici: Një vështrim ekonomik për Kutelin

Të nderuar miq dhe kolegë, autoritete të qytetit të Pogradecit, që na dhatë nderin dhe kënaqësinë për të folur për një figurë të shquar siç është Mitrush Kuteli. Aq sa ndjeva kënaqësi kur mora këtë ftesë, të cilën e pranova menjëherë, ndjeva edhe një lloj përgjegjësie për një figurë si Kuteli e cila për ditë e më tepër ndoshta po na zbulon një pjesë relativisht të panjohur të saj, atë që po të hapësh wikipedian ose fjalorë të ndryshëm ku shkruhet për Kutelin, përmendet Kuteli si letrar, Kuteli si atdhetar dhe ekonomist.

Ndërkohë po kërkoj të gjej diçka, Kutelin edhe si ekonomist, por është vërtetën shumë zor jo thjesht për të gjetur një material por edhe për të pasur një opinion. Ndoshta është personale por dua ta ndaj me ju. Kur mora ftesën ua tregova kolegëve të mi në universitet, por edhe djalit tim. Reagimi i tyre ishte njësoj. Më thanë: –Civic, qëkur ke filluar të merresh me letërsi apo me atdhedashuri dhe do shkosh të flasësh për Kutelin? Iu thashë: – Nuk shkoj të flas për një vlerë, (që edhe fjala e Z. Plasari me gjithë melodinë dhe substancialitetin e saj ishte e mrekullueshme për ta përshkruar), padyshim do të flas për ekonominë, sepse për aq sa ju mendoni që e barazoni Kutelin me “Tregime të moçme shqiptare” apo me shumë vepra të tjera të atdhedashurisë.

Në Bankën e Shqipërisë ose në ambiente të tjera në Republikën Financiare, Kuteli përmendet për disa elementë dhe disa veti të tjera të tij që ngelen t’i zbulojmë. Dhe merret me mend një shprehje e Makjavelit, i cili në kujtimet e tij thotë, që sa herë shkoja në bibliotekën e shtëpisë time, vishesha mirë, me kostumin më të mirë, me papjonin më të mirë, sepse kisha takim me një letër të shënuar dhe me duhet ta respektoj. Mbasandej, ekonomist në një studio të vetme, pikërisht në këtë aspekt për t’ia mbushur ato vlera të porsalindura për të cilat edhe sot u tha.

Së pari, dy veprime shumë sinjifikative që Kuteli ka bërë në



profesionin e tij si bankier, në profesionin e tij si financier. Së pari, në 44-ën, kur kishte vetëm 2 vjet që ishte kthyer nga Rumania dhe punonte në bankat e Shqipërisë dhe ishte një nga administratorët, kontribuesit kryesorë që merrej dhe me arin, me ruajtjen, përdorimin e arit dhe monedhës shqiptare.

Refuzoi që të nënshkruante e të bëhej pjesë e një projekti gjerman, për të krijuar një monedhë të përbashkët, siç kishin bërë gjermanët në shumë vende që kishin pushtuar, e cila ishte një nga format për të justifikuar tërheqjen e parë, e largët në këto vende. E natyrisht rrezikoi dhe jetën e tij me një veprim për të mbrojtur arin e Shqipërisë, të paktën në ato dokumentet që ne lexojmë ekziston një frymë e komandantit gjerman, që po e kapëm do ta pushkatojmë në vend.

Kjo tregon më së miri se sa i vërtetë dhe sa thelbësor ishte Kuteli në atë vendim që kishte marrë, gjë që e bëri pastaj të radhisej mbrapa tezkës në Tiranë për t’i shpëtuar kapjes dhe pushkatimit. Dhe së dyti një vendim dhe një veprim po kaq i guximshëm dhe kaq i mençur do thoja ishte rezistenca e refuzimit të tij në projektet që qeveria komuniste shqiptare në kuadrin e marrëdhënieve shumë të ngushta me ish-Jugosllavinë e asaj kohe kërkoj që të bënte planifikimin në banorë dhe ndërmjet të tjera dhe ratifikimin e monedhës shqiptare, çka do ishte ndoshta një nga

katastrofat më të mëdha. Sepse ndërsa ne vërtet ishim vend i varfër, por kishim mall dhe kishim ar, monedha jugosllave ishte një monedhë inflacioniste që një monedhë që më shumë do të na shfrytëzonte sesa do përfitonim.

Dhe pikërisht në atë kohë shumë të vështirë do thoja e të rrezikshme ideologjike, Kuteli guxoi dhe tha jo e nuk u bë pjesë e një plani dhe ndoshta ose jo ndoshta, por ekzaktësisht për këtë vuajti pastaj pasojat gjatë gjithë jetës duke marrë etiketime nga më të ndryshmet. Ndoshta në eksplorimin e një personaliteti ose edhe të një njeriu të zakonshëm, mjaftojnë vetëm dy mendime të tilla, dy veprime të tilla për t’u futur në grupin e njerëzve të shquar, që çdo popull i zotëron, i nderon. Por Kuteli është edhe më shumë se kaq, unë dua të përmend edhe dy elementë të tjerë po kaq të rëndësishëm. Duke parë se çfarë ka shkruar kur ai mbrojti doktoraturën në fushën e ekonomisë, në Bukuresht të Rumanisë.

Ndoshta Kutelit njëzëri i thonë që s’e ka deri tani, por duhet ta ketë në panteonin e atyre që ne i quajmë vendimtare në trajtimin e teorisë ekonomike. Ekonomistë të shquar që jo thjesht kanë komentuar dhe kanë kumbuar si ekonomistë, por e kanë trajtuar teorikisht shkencën e ekonomisë.

Dhe më lejoni t’iu them meqë jam i këtij profesioni, që në Shqipëri ka shumë pak njerëz që meritojnë të quhen teoricienë dhe ekonomistë

dhe mund të lexohen e të studiohen si të tillë. Duke parë disa nga botimet e Kutelit, sot pata kënaqësinë të kem një libër që shpresoj shumë shpejt dhe ju do ta keni, që familja e ka botuar, por që mendoj është shumë i pjesshëm në krahasim me veprën e tij, e cila gjendet akoma e botuar normalisht dhe ka ardhur në Shqipëri. Është vërtet emocionuese të shikosh një autor shqiptar, që flet për çështje madhore në vitet 30, 40 në Rumania; që flet për bankat qendrore; që flet për imitimin e monedhës; që flet për huamarrjen apo kreditin; që flet për bankat bujqësore dhe bankat e zhvillimit; që flet për pasojat e krizës së 29-ës, 93-shit dhe si mund të menaxhohej konventa e krizave me vendime të politikave monetare, politikave financiare ose menaxhimeve me paranë.

Dhe mbi të gjitha trajton një nga figurat më të shquara në shkencën ekonomike që ndoshta për auditorin do të jetë një emër i panjohur, por për ata që merren me historinë e ekonomisë është emër shumë i njohur: Sizmonde Sizmondi që është një ish-kont francez, një nga figurat më të shquara, me teorinë e të cilit filloi edhe industrizimi i botës moderne, industrizimi i Francës, Gjermanisë, Anglisë, ato vende, ku ndodhi revolucioni industrial. I cili, tregoi që nuk mund të zhvillohet një komb vetëm nëpërmjet tregtisë, por duhet zhvilluar në radhë të parë nëpërmjet industrisë, nëpërmjet prodhimit, nëpërmjet një ekonomie kombëtare, e cila i krijon gjithë premisat për të qenë një vend i qëndrueshëm dhe pastaj politikisht dhe për mirëqenien e tij.

Do ishte në nderin tonë, jo vetëm si dëshirë apo si përgjegjësi e familjes, por edhe dikush nga ne të mund ta risillte në shqip dhe në Shqipëri veprën e plotë të reflektimeve dhe të mendimeve ekonomike të Kutelit për t’ua treguar studentëve tanë, jo vetëm ata që studiojnë ekonomi dhe financë, por edhe ata që merren me problemet e ekonomikut e më gjerë, që i vetmi autor shqiptar ndoshta mund të jetë pjesë e reflektimit, mendimit teorik.

FJALA E MIRUSH KABASHIT PËR KUTELIN

Kuteli është madhështor kudo

Përshëndetje të gjithëve! Nëqoftëse, do të më lejoni, mbase ky është rast i mirë të shpreh edhe unë disa gjykime të miat shumë vlerësuese. Jeni të lejuar të gjykoni për vlerën e tyre. Mua s' do të më vijë fare keq, ato mund të shprehin edhe injorancën time.

Por nuk lejoj asnjëri, të mos guxojë njeri të dyshojë një miligram në sinqeritetin e këtyre që them. Unë gjykoj, që nuk i takon Pogradecit Mitrush Kuteli, aq më pak familjes së tij, ai i takon Shqipërisë dhe shumë më tepër kombit shqiptar. Është një krenari e jashtëzakonshme. Bie dakord me Z. Civici dhe natyrisht me prof. Plasarin, i cili vërtet i jep një vlerë shumë të madhe dhe është për të ardhur keq që është një nga kolonat e letërsisë, një nga majat e njohurisë së letërsisë dhe të krijimit të letërsisë, sic është Plasari këtu, se duhet të ishin shumë me tepër.

Duhet kokë e madhe për të promovuar dhe për të nxjerrur jo vlerat e Mitrush Kutelit, po për të nxjerrur vlerat e intelektualizmës sonë, vlerat e letërsisë sonë, vlerat e patriotizmit tonë, po vlerat qoftë të studjuesit tonë në fushën e financave. Unë kam fatin të jem prej 20 vjetëve, ndoshta më shumë me Kutelin. Më besoni kam patur



fatin të kem edhe poezitë prej rilindasve tanë më të shquar ndoshta edhe në shekuj, po vetëm poezi e Mitrush Kutelit me "Poemi kosovar" deri 3 muaj më parë, kam patur 4 ose 5 herë gjatë recitimit që salla të cohet në këmbë. Kjo gjë më ka bërë vaki në Tetovë dhe unë jam kënaq.

E kam recituar këtë poemë, ma ka sygjerruar Gjergj Vlasi. Nga vitet 87: - Shiko po ta jap këtë, mendo në një libër të vjetër, po në qoftë se do të ta zenë, mos thuaj që ta kam dhënë unë. Unë do të ta mohoj. Unë do të ta jap meqë je kosovar. Atje ishin 2 poema të

mëdha, sic janë "Letër nga Shën Naumi" dhe "Poem' kosovar".

Më lejoni të bëj edhe një krahasim tjetër. Pse zakonisht ndodh që mendimi letrar shqiptar të thotë që Kuteli është prozator, por nuk është e vërtetë. Kuteli është madhështor kudo që ta kemi. Ashtu siç ka prekur në Finance dhe ka bërë libra, ashtu si në burrëri, në patriotizëm, në letërsi, po flasim në prozë ashtu edhe në poezi është madhështor kudo që prek. Dhe është e vërtetë. Ai merr një copëz gur dhe ai bën djaman, ai merr një copë baltë dhe me 40 fjalë ai bën një traktat estetik të mirëfilltë, që t'ia kenë zili edhe ato qindra faqe e volume në spektrin që janë të afirmuara. Ai bën poezi me atë ngjeshje, që ai di të themi të nxjerrë dhjamë edhe nga pleshti...

Unë ju falendëroj shumë që më dhatë mundësinë të shpreh një pjesë të atij admirimi që unë e kam të thellë ndaj kësaj figure. Unë nuk jam njohës i Kutelit. Lum ata që janë njohës të tij. Po recitoj "Poem' kosovar", që e kam recituar pothuajse kudo në Evropë, në mbi 20 vende, për herë të parë në Tetovë, për herë të dytë në Pejë, në afro 90 qytete. Me lejoni t'ju them një gjë Z.Civici. Për herë të parë në një metim që u bë përpara

presidencës për Kosovën, recitova "Poem' kosovar". Tashmë nga Peja, dhe kisha kuptuar, natyrisht unë e mësova dhe nuk i qëndrova besnik Gjergj Vlasi, kur më tha lexoje poemën e ma kthe, unë atë poemë e kopjova dhe e dija forcën e saj. Por pasi e kam recituar dhe atë e transmetoi TVSH-ja në 93-shin apo 94-n, mua më është afruar një burrë me flokë të bardhë. Nuk po ju uroj që keni recituar poezinë dhe e keni recituar bukur, po unë jam një nga miqtë e ngushtë të Mitrush Kutelit dhe kam punuar në aparatit e Komitetit Qendror për shumë vite, natyrisht kontaktet me familjen i mbaja vonë natën që të mos më shikonin se natyrisht miqësitë dhe hyrjet e daljet te ajo familje shikoheshin si jo gjë e mirë. Tha: - Po unë ju siguroj që një pjesë e mirë e kalvarit të tij nuk ka ndodhur qoftë edhe burgu, jo se nuk pranoi të njehësohej dinari me lekun, por për "Poem' kosovar", e cila edhe pse është shkrojtur në vitin 1942 ajo është konsideruar si tabu dhe nuk u lejua në mënyrë absolute. Pavarësisht nga fasadat që shikoshim apo nga librat që thoshim, atë që kërkonte Kuteli, që kërkonte atë që ne po e marrim sot me kaq mundim atë që i takon Kosovës, atë nuk mund ta mohonte sistemi.

Botohet për herë të parë letra e Fan Nolit drejtuar Mitrush Kutelit

Ekskluzivish për gazetën "Nositi", nga familja Pasko


28 / VII / 46

I dashur vëllá,

Mora letrat túaja, dhe ju falem nderit për sa më shkruáni. Nukë di á ju ra "Dielli" në dorë, dhe á i kënduat disá vjersha, origjinale dhe të përkthyerá, që kam botuar këtë' vit. Nëqóftëse jo, shkruámëni tjua dërgónj. Kisha shpresë tjua sillnja vetë, po tani shoh me hidhërim që vizita ime në Shqipëri munt të shtyhet për një të pritme jo shumë të áfërme. S'munt të tundem së këtejmi pa shtypur nja katër libra për të cilat jam paguar, dhe dy prej të cilave nuk i kam shkruar akoma. Mi këtë duhet të shtoni që është zor për të gjetur shtypës dhe kartë. Pra, durim.

Me bekime prej zëmre, mbetem urónjësi juaj me Krishtin

+ F. S. Noli



Bota Lasgushiane, Atdheu, Dashuria, Natyra



Që nga Homeri i madh e deri më sot, tri janë temat e mëdha të letërsisë së madhe botërore: atdheu, dashuria, natyra-të cilat poeti ynë Lasgush Poradeci i përmendte shpeshherë në bisedat e tij.

Të gjithë ne jemi të gëzuar që ndodhemi në këtë ditë dimërore në Pogradec në qytetin e dy magjistarëve të gjuhës shqipe; e poetit të madh Lasgush Poradeci dhe poetit të prozës Mitrush Kuteli. Poezia e Lasgushit e shkruar në kohë të errëta ngaherë më kujton atë vargun aromatik dhe farfuritës të këngës popullore "Manushaqe e Prillit në mes të Dëborës". Lasgushi i dhuroi poezisë shqipe një grusht me lirika të xhevahirta, pa të cilat, me siguri ajo do të ndihej e mangët. Ato u krijuan nga muza e tij poetike prej një talenti të posaçëm dhe prej ndërgjegjes së tij artistike. Thonë se krijoi pak, por kjo s'është e vërtetë.

Ai krijoi aq sa i duhej një artisti për të qenë zë më vete, stilist i pangatërrueshëm dhe lartësi poetike e një kohe që vështrohet prej të gjithë koordinatave të kohrave që vijjnë.

Bota objektive dhe bota subjektive u shkrinë në një letërsi të vetme dhe krijuan një botë artistike të emërtuar atë që ë quajne

botë lasgushiane. Bota lasgushiane është një botë e plotësuar pavarësisht nga madhësia e saj, por bota si botë, ka beharin ka dhe dimrin e saj.

Lasgushin, shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare e ka quajtur nositi i poezisë shqipe dhe është një cilësim dhe epitete shumë i bukur dhe përcaktues për këtë poet. Poeti ynë Lasgush e përballoi atë masë kohe që duhet si gur prove për të mbetur në tempull të artit, kultin e këtij arti. Këtë tempull ai e përjetoi gjatë gjithë jetës së vet. E vërteta se koha i ktheu dhe po kthen shumë gjëra të cilat më parë kritika në stadin e saj edhe foshnjoria kishte mohuar dhe është më mirë kështu kur t'i kthejnë borxhet sesa kur ke për të kthyer borxhe. Arti emocionon. Ja një mësim që na jep ne të gjithë brezave poezia e Lasgush Poradecit. Poeti nxjerr në dritë të diellit dhe bën me gojë ndjenjat më të thella, më të fshehta të shpirtit njerëzor. Ai është një eksplorator i thellësive të shpirtit të njeriut dhe i bërthamave dramatike ku ndeshen dritëhije dhe çlirohen energji njerëzore.

Këtë karakter dramatik të poezisë së tij e ka vënë re që në 1929 profesori i shquar Eqerem Çabej.

Ndjeshmëria e lartë derdhet në forma të brishta dhe të tejdukshme.



Të gjithë jemi ndodhur në çaste vetmie dhe përhumbjeje. Patjetër, s'ka sesi të mos të të kujtohet dhe vargu i Lasgushit që e derdh si në bronx këtë moment.

"Futet zemra djaloshare mu në fund të shpirtit tim"

Çfarë abstragimi dhe çfarë fantazie e ndezur poetike. Pa to nuk ka art madhor. Poezitë filozofike të peisazhit dhe të dashurisë të poetit Lasgush Poradeci janë poezi të dinjitetit njerëzor. Është e vërtetë që atij më fort se jeta i intereson ëndrra, pra jeta e përsosur. Disi mbikohore, mbarëkohore, i intereson një planetarizim idesh, ndjenjash, vizionesh.

Kur distancohet nga jeta edhe magma e tij poetike ftohet, mbështillet me mjegulla, kur afrohet me të dhe këtu është pikërisht forca e tij, atëherë dhe arti poetik lasgushian ka freskinë e burimeve malore ose ngrohtësinë e ujërave termale të tokës.

Ndoshta një nga këto rivlerësime të poezisë të Lasgushit, të cilat kritika dikur ja kishte mohuar do ishte, nëse ajo është poezi sociale apo nuk është poezi sociale. Sigurisht ka patur ekstrimitete në të, por e vërteta është që kjo është një poezi sociale e tërthortë. Nuk është e karakterit të drejtpërsëdrejtë të Migjenit, por po të mungonte ajo do t'i mungonte një nga pemët e bukura kopshtit poetik shqiptar.

Me Lasgushin gjuha artistike e papërdhunë, në qoftë se shprehemi me një fjalë të tij, u përkrye, arriti një pastërti, një muzikë, një përqëndrim ndjenje dhe mendimi. Ai na mësoi se poezia është arti i kuptimit të fjalëve, por edhe i magjisë tingullore të tyre, i pasurisë së ritmeve dhe i figurave brilante.

Lasgushi ishte i dashuruar me këtë tokë, me këto këngë, më këtë liqen, me këtë gjuhë kaq të fuqishme, por edhe kaq të ëmbël si prej mjalti. Po të kërkonim një metaforë të jetës dhe të veprës së Lasgushit, unë do thoja që ajo që e përfaqëson atë kudo është liqeni

Shkruar nga: **Budjon XHELO**

i Poradecit, të cilit ai i këndoi me aq zjarr dhe aq bukur. Liqeni ishte shoku i tij, ishte sozia e tij, vetja e tij e dytë. Diku ai thotë:

"Si shpirt i zi në kraharuar u mbyll liqeri nënë male"

Arti pëmbi liqen,

Liqeni pëshpërit emrin e poetit,

Dhe nxjerr nga gjiri si një nosit,

që lajmëron mëngjesin, vargun e tij,

këngën e tij të pavdekshme

POETI BËN ATDHE, funksionarët kalojnë,- i ka thënë poeti një funksionari të lartë partie në vitin 1981. Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Migjeni, Asdreni, Lasgushi, Mitrush Kuteli, Dritëro Agolli, Ismail Kadare etj., është kolana e poetëve që bëjnë atdhe.

Qyteti i Pogradecit ka privilegjin t'i ngajë qytetit gjerman Vajmar që ka nxjerrë Gëten dhe Shilerin.


Sot Lasgushin dhe Mitrushin i kemi në bronx dhe i gjithë qyteti krenohet me ta. Duke u shprehur falënderimet e mia për ato çka thashë dhe ju patët mirësinë të më dëgjoni, dua t'ju tërheq vëmendjen se Poradeci i Lasgushit është një klimë e begatë, që nxjerr nga gjiri i kaltër shumë poetë të talentuar.

Dua të veçoj me këtë rast Anastas Kostandinin (Taso), poetin e pikturës që flet shumë bukur me lapsin e penelin e piktorit, duke vazhduar artin e tij, rrugën dhe famën e Lasgushit.

Së fundi dua t'i bëj me dije këtij auditori të nderuar, se Lasgushi është një pasuri e paçmueshme, që na fisnikëron shpirtin, me dashurinë për Atdhe, për gjuhën tonë të mrekullueshme, ndaj dhe çdo vit, është detyrimi ynë t'ia festojmë ditëlindjen.

Kjo shpjegon edhe 112, 113, 114... vjetorin.

ARDIAN - CHRISTIAN KYÇYKU - "Perla"



Libri më i ri
botuar nga
Shtëpia
Botuese
"DIJA -Poradeci"

Mekanizmi i Referimit Kundër Dhunës - në Veprim

Shoqata “Unë, Gruaja”, në kuadër të angazhimeve që ka marrë si anëtare e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Pogradec, do të organizojë 6 (gjashtë) workshop-e në periudhën Maj-Qershor 2012.

Pjesëmarrës në këto workshope do të jenë institucione e aktorë të tjerë, të cilët në bazë të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar) neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, janë pjesë e Mekanizmit Referues në Pogradec:

Zyra për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje,

Komisariati i Policisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Prokuroria e Rrethit, Zyra e Përmbartimit, Mjeku Ligjor, Drejtoria e Shëndetit Publik, Qendra Shëndetësore, Drejtoria Arsimore, Zyra e Punësimit, Shoqata “Unë, Gruaja”, Dhoma e Avokatisë, etj.

Në këto workshop-e secili institucion do të prezantojë rolin e vet, detyrimet, përgjegjësitë, e angazhimet sikurse janë të përcaktuara në ligj.

Do të diskutohen metoda dhe mundësi praktike të ndërveprimit, duke krijuar një sistem të reagimit të koordinuar, të përshtatshëm në kontekstin e komunitetit tonë, për të ofruar mbështetjen dhe shërbimin efektiv për personat që janë viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare.



Shitje shtëpie

okazion

Cel: 0692750617
Cel: 0682072562

Shitet një apartament në Pogradec, 1+1 me dy ballkonë.
Banesa ndodhet në qendër të qytetit, me pamje nga liqeni, 100 metra larg bregut të liqenit.
Sipërfaqja 55 metra katrore, kati i 7-të (pa ashensor). Shitet bashkë me pajisjet.

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Gazetarë: Ilir Buzali, Dhimitër Gegprifti
Korrespondente: Alda Isallari, Dorian Leka
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "DIJA - Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com